



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 12.4.2023

Nr: 329

Ora: 12:00

**VENDIM**

**PËR**

**VERIFIKIMIN E TË DHËNAVE NË FORMULARIN E VETËDEKLARIMIT TË SUBJEKTIT  
VETËDEKLARUES Z. EULAND HAKI DAJA, KANDIDAT PËR ANËTAR NË KËSHILLIN BASHKIAK, I  
PROPOZUAR NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR "PARTIA DEMOKRATIKE" PËR BASHKINË SHIJAK**

Sot më datë 12.4.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në seancë publike shqyrtova çështjen me:

**Objekt:** Për verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues z. Euland Haki Daja, kandidat për anëtar në këshillin bashkiak i propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Demokratike" për Bashkinë Shijak.

**Baza ligjore:** Neni 19, pikat 1, shkronja "n" e 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenet 5 dhe 11 të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Kreut II, III, V, të vendimit nr.17/2016, të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike",

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

**V Ë R E J:**

Në zbatim të ligjit nr.138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për

Data: 12.4.2023 Nr: 329  
Ora: 12:00



"Për verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues z. Euland Haki Daja, kandidat për anëtar në këshillin bashkiak ,i propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Demokratike" për Bashkinë Shijak".

funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte ndër të cilat është edhe kandidati për kryetar bashkie apo anëtar në këshillat bashkiak.

Me vendim të KZAZ-së, z. Euland Haki Daja, është regjistruar si kandidat për anëtar në këshillin bashkiak të Bashkisë Shijak, i mbështetur nga Partia Demokratike. Për këtë kandidat në datën 29.3.2023, pranë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është depozituar formulari i vetëdeklarimit i cili është regjistruar me nr. unik DR-PDSH-8603. Në kuadër të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit të këtij kandidati, sipas përcaktimit të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (DPGJ).

Në përgjigje të kësaj kërkesë të Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, DPGJ informon se kandidati në fjalë nuk është e dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Euland Haki Daja, rezulton:

- Në rubrikën I. “TË DHËNA PERSONALE”, PIKA B, “Gjeneralitete të mëparshme” të Formularit të Vetëdeklarimit, subjekti vetëdeklarues ka deklaruar se nuk ka ndryshim tek gjeneralitetet e tij;
- Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit, pyetjes 1 “A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “PO”, duke deklaruar se është proceduar nga Gjykata e Bazelit, Zvicër, dënimin me 10 muaj burgim, duke mos deklaruar numrin e vendimit të gjykatës ;
- Pyetjes 3 “A keni qenë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj, për kryerjen e një veprë penale?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “PO”, duke deklaruar se është proceduar nga Prokuroria Bazel Zvicër në vitin 1998-1999. Subjekti nuk ka deklaruar veprën penale dhe masën e dënimit;
- Pyetjes 4 “A keni qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një veprë penale?” subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “PO”, duke deklaruar se është proceduar nga Prokuroria Bazel Zvicër në vitin 1998-1999. Subjekti nuk ka deklaruar veprën penale dhe masën e dënimit;
- Pyetjes 8 “A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se një muaj?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “PO”, duke deklaruar se ka jetuar si emigrant ne Bazel, Zvicër nga viti 1998-1999; Si emigrant në Venezia, Itali nga viti 2018-2019.

Në vlerësim të përmbajtjes së deklarimeve si më sipër në formular, KQZ çmon se është e nevojshme marrja e informacioneve shtesë në lidhje me faktet që lidhen me autoritete dhe vende të huaja. Në nenin 2, pika 2, të ligjit nr. 138/2015, përcaktohet se për vepra penale të kryera jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, KQZ, nuk ka kompetencën për të kryer verifikime.

Referuar nenit 8, pika 1, të ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e Integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreu V, pika 3, shkronja “b/ii)”, të vendimit nr. 17/2016 të

Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, është Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit, që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pikat 12 dhe 13 të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

### **V E N D O S:**

1. Kryerjen e verifikimit të thelluar të subjektit vetëdeklarues z. Euland Haki Daja kandidat për anëtar në këshillin bashkiak i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Demokratike” për Bashkinë Shijak dhe dërgimin e të dhënave përkatëse Prokurorisë së Përgjithshme për vlerësim të mëtejshëm.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**